VENDIM
Nr.1, datë 25.1.2005

PËR MIRATIMIN E RREGULLAVE TË TREGUT TË ENERGJISË ELEKTRIKE

Në mbështetje të nenit 54 të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 "Për sektorin e energjisë elektrike", Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë Elektrike në mbledhjen e tij të datës 25.1.2005, mbasi shqyrtoi draftin e paraqitur nga Task-Forca e ngritur për përgatitjen e këtyre rregullave,

VENDOSI:

1. Të miratojë rregullat e tregut të energjisë elektrike (Rregullat bashkëngjitur këtij vendimi).
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI I ERE-S
Pjetër Dema

RREGULLAT E TREGUT PËR TREGUN E ENERGJISË ELEKTRIKE

KAPITULLI I
RREGULLA TË PËRGJITHSHME

Neni 1
Autoriteti për miratimin e rregullave të tregut

Autoriteti për miratimin e rregullave të tregut ("RrT") për tregun e energjisë elektrike ("TE") bazohet në ligjin nr.9072 "Për sektorin e energjisë elektrike" ("LSE"), konkretisht në nenin 54 të LSE.

Neni 2
Objektivat

1. Objektivi i RrT-së është vendosja e rregullave transparente dhe jodiskriminuese për të siguruar kërkesat minimale për fazën fillestare të tregut kombëtar të energjisë elektrike në Shqipëri dhe pjesëmarrjen e Shqipërisë në një treg rajonal të energjisë elektrike ("TRE") sipas angazhimeve të Shqipërisë, të përcaktuara në marrëveshjet ndërkombëtare.

Këto RrT do të plotësojnë dhe janë të pandara nga:

a) kërkesat për operimin teknik të Sistemit Elektroenergjetik, Kodit të Sistemit të Transmetimit dhe Kodit të Funksionimit të Shpërndarjes dhe Kodit të Matjes;

b) parimet e MTT-së të miratuara nga QSh-ja me vendimin e Këshillit të Ministrave nr.539 në 12 gusht 2004.

2. Bazuar në LSE-në, ERE-ja është përgjegjëse: (a) për përcaktimin e të drejtave dhe detyrimeve respektive të pjesëmarrësve të tregut sipas rregullave dhe rregulloreve transparente dhe jodiskriminuese që lejojnë aksesin e palëve të treta; dhe (b) për të siguruar kontroll rregullator për TE-në. ERE do të monitorojë në mënyrë të vazhdueshme tregun për të siguruar mënjanimin e diskriminimit, konkurrencën efektive dhe funksionimin e tij efektiv. RrT do të përcaktojnë të drejtat dhe detyrimet e pjesëmarrësve të tregut në TE. Në varësi të zhvillimit të infrastrukturës së sektorit elektroenergjetik (si p.sh., por jo vetëm duke u kufizuar në këto, aftësitë e linjave të interkoneksionit, Qendrës Dispeçer etj.), ERE bën rishikimin e RrT në mënyrë që këto të fundit të reflektojnë këto zhvillime të këtij sektori.

3. Gjithë aspektet e sistemit të transmetimit dhe operimeve të tregut funksionojnë në mënyrë transparente me kontroll rregullator nga ERE për të eliminuar çdo dyshim për diskriminim që do të pengonte zhvillimin e tregut. Rregullat e tregut dhe kodet që lidhen me to sigurojnë fleksibilitet që tregu të operojë në mënyrë transparente, efiçente dhe pa diskriminim.

Neni 3
Përkufizime

Përveç kur përkufizohen ndryshe, termat dhe shkurtimet e përdorura në RrT do të kenë

kuptimin e dhënë në shtojcën B.

KAPITULLI II
PJESËMARRËSIT E TREGUT

Neni 4
Pjesëmarrësit e tregut

Pjesëmarrësit e mëposhtëm të tregut do të licencohen ose autorizohen nga ERE që të marrin pjesë në TE: sh.a. KESH, Operatori i Sistemit të Transmetimit ("OST"), kompania(të) publike e gjenerimit ("KPGJ") (pas krijimit), kompania(të) e shpërndarjes ("KSH") (pas krijimit), klientët e kualifikuar ("KK"), furnizuesit e kualifikuar ("FK") (vendas ose të huaj), furnizuesit e jashtëm ("FJ") (që sipas legjislacionit aktual nuk kanë nevojë të licencohen ose të autorizohen nga ERE), prodhuesit e vegjël të energjisë ("PVE"), prodhuesit me kogjenerim ("PKE"), prodhuesit e pavarur të energjisë ("PPE") dhe prodhuesit e privilegjuar të energjisë ("PP").

Neni 5
Roli i KESH-it

Sa kohë që aktiviteti i shpërndarjes dhe i prodhimit të energjisë elektrike janë brenda sh.a. KESH-it, roli dhe funksionet e KSH-së dhe KPGJ-së, të parashikuara më poshtë, do të realizohen nga sh.a. KESH-i.

Neni 6
Roli i OST-së

1. OST-ja merret me operimet e tregut, objekt i kontrollit të ERE-s. OST-ja do të jetë përgjegjëse për operimin e sigurt dhe të qëndrueshëm të sistemit të transmetimit. OST-ja nëpërmjet Qendrës së saj Kombëtare Dispeçer "QKD", do të sigurojë menaxhimin në kohë të operimit të sistemit të transmetimit, mbajtjes së një balance të qëndrueshme mes burimeve të furnizimit dhe kërkesës, shkëmbimin e energjisë elektrike, si dhe transaksioneve të tjera konform akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi.

2. OST-ja:

a) Licencohet nga ERE për të kryer aktivitete që lidhen me transmetimin dhe tregun sipas nenit 41 të LSE-së dhe nenit B.1.a të MTT-së;

b) Siguron si shërbim publik, shërbimin e transmetimit të energjisë elektrike për furnizim me energji elektrike për klientët tariforë;

c) Operon sistemin sipas dispozitave të (i) RrT-ve dhe Kodit të Funksionimit të Rrjetit të miratuar nga ERE dhe (ii) udhëzuesit të operimit të UCTE-së, dhe marrëveshjeve të tjera ku OST është palë (siç janë marrëveshjet ndërmjet TSO – ve të rajonit dhe më gjerë për Cross Border Trading (CBT), Congestion Management etj.);

d) Siguron mekanizma të mjaftueshëm për balancimin orar me qëllim që të mbrojë qëndrueshmërinë operuese të sistemit sipas marrëveshjes së rregulluar vjetore dhe shtesë të shërbimeve ndihmëse;

e) Menaxhon flukset e energjisë në sistem nëpërmjet Qendrës Kombëtare Dispeçer (QKD-së), duke marrë në konsideratë shkëmbimet me sistemet e ndërlidhur, përfshirë menaxhimin e transitit të energjisë elektrike mes sistemeve fqinje duke përdorur sistemin e transmetimit, për të siguruar një sistem operimi të sigurt, të qëndrueshëm dhe efiçent;

f) Kontrollon dispeçerimin e energjisë në sistem nëpërmjet QKD-së;

g) Zhvillon dhe zgjeron sistemin e transmetimit në përputhje me parashikimet afatgjata dhe planet e zhvillimit të sektorit të energjisë elektrike për të siguruar kapacitet transmetimi të ardhshëm të mjaftueshme (i) për të plotësuar kërkesat e arsyeshme për transmetimin e energjisë elektrike dhe (ii) për të garantuar siguri furnizim dhe qëndrueshmëri të sistemit;

h) Siguron mirëmbajtjen e aseteve që zotëron, si dhe aftësive dhe pajisjeve që lidhen me to, të sistemit të transmetimit, në përputhje me kërkesat e zbatueshme teknike dhe të sigurisë;

i) Ruan aftësitë ekzistuese të interkonjeksionit me sistemet elektroenergjetike të vendeve të tjera dhe do të ndërtojë aftësi dhe linja të reja interkonjeksioni siç mund të vendoset nga Këshilli i Ministrave sipas nenit 31 të LSE-së;

j) Operon sistemin e transmetimit të energjisë elektrike të Shqipërisë paralel me sistemet e ndërlidhura të energjisë elektrike të vendeve të tjera në TRE, në përputhje me marrëveshjet dy ose shumëpalëshe, dhe kërkesat e operimit të sigurt dhe standardet e interkonjeksionit të vendosura nga ERE sipas nenit 55 të LSE-së;

k) Kooperon me kompanitë që operojnë në fushën e energjisë elektrike (në rajon dhe më gjerë) për të siguruar qëndrueshmërinë dhe operimin e vazhdueshëm të gjithë aftësive të interkonjeksionit;

l) Siguron shërbim transmetimi për (i) prodhuesit dhe (ii) furnizuesit e licencuar të energjisë me tarifa jodiskriminuese me terma dhe kushte aksesi të rregulluara nga ERE;

m) Siguron shërbim transmetimi për (i) KSH-n, (ii) furnizuesit e kualifikuar (vendas dhe të huaj), (iii) klientët e kualifikuar që kanë kontratë me OST-në për shërbimin e transmetimit dhe (iv) klientët tariforë të lidhur direkt me sistemin e transmetimit me tarifa të rregulluara jodiskriminuese;

n) Siguron lidhjen me sistemin e transmetimit të pjesëmarrësve të licencuar të tregut, sipas rregullave të vendosura në Kodin e Sistemit të Transmetimit;

o) Propozon dhe merr miratimin nga ERE për tarifat e transmetimit në përputhje me metodologjinë e tarifave të miratuar nga ERE.

Neni 7
Roli i KSH-së

KSH:

a) Kompania(të) që kryen aktivitetin e shpërndarjes, licencohet nga ERE sipas nenit 43 të LSE-së për të siguruar shërbimet e shpërndarjes së energjisë elektrike në zonën e mbuluar nga rrjeti i saj i shpërndarjes;

b) Siguron, si shërbim publik sipas neneve 25 dhe 43 të LSE-së, furnizimin me energji elektrike për gjithë klientët tariforë që furnizohen nga sistemi i shpërndarjes;

c) Menaxhon rrjetin e shpërndarjes dhe koordinon me OST-në menaxhimin e flukseve të energjisë në sistemin elektroenergjetik;

d) Siguron mirëmbajtjen e aseteve, që zotëron, si dhe aftësive dhe pajisjeve ndihmëse që lidhen me to, të sistemit të shpërndarjes në përputhje me kërkesat e zbatueshme teknike dhe të sigurisë që parashikohen në Kodin e Funksionimit të Shpërndarjes;

e) Zhvillon dhe zgjeron sistemin e shpërndarjes në zonën e mbuluar në përputhje me parashikimet afatgjata të kërkesës për energji elektrike dhe planet e zhvillimit ekonomik për të siguruar asete të përshtatshme shpërndarjeje (i) për të plotësuar kërkesat në rritje për energji elektrike dhe (ii) për të garantuar siguri të furnizimit dhe qëndrueshmëri të shërbimit;

f) Realizon gjithë shërbimet e nevojshme të klientëve për të plotësuar detyrimet e shërbimit publik për klientët tariforë, në përputhje me kontratat e saj të shërbimit dhe çdo standard ose rregullore lidhur me kushtet e shërbimit të miratuara nga ERE;

g) Operon sistemin e shpërndarjes në përputhje me Kodin e Funksionimit të Shpërndarjes të miratuar nga ERE;

h) Siguron shërbime lidhjeje dhe shpërndarjeje për furnizuesit e kualifikuar, apo kur është rasti për klientet e kualifikuar, që kontraktojnë për furnizimin me energji nga burime të tjera dhe marrin furnizim nga sistemi i shpërndarjes;

i) Siguron lidhje me sistemin e shpërndarjes për çdo PVE që është licencuar nga ERE dhe që ka kontraktuar për t'i shitur energji një furnizuesi të kualifikuar apo kur është rasti një klienti të kualifikuar apo një pjesëmarrësi tjetër në TE, me kusht që kostoja e kësaj lidhjeje të përballohet nga PVE-ja dhe të plotësojë gjithë kërkesat e zbatueshme teknike dhe të sigurisë.

Neni 8
Roli i KPGJ-së

1. Në përputhje me nenet 23 dhe 33 të LSE-së, me qëllim që të shmangë ndërsubvencionimin

dhe shtrembërimin e konkurrencës ndërkohë që KPGJ-ja operon si divizion i KESH-it, KESH-i do të ndajë gjithë llogaritë financiare që lidhen me aktivitetet e gjenerimit.

2. KPGJ-ja aktualisht zotëron dhe operon gjithë njësitë ekzistuese të gjenerimit hidroenergjitik në sistem. Fillimisht, në TE e gjithë energjia elektrike e prodhuar nga njësitë ekzistuese hidroenergjetike do të përdoret për furnizimin e klientëve tariforë me tarifa të rregulluara, me qëllim që të sigurohet qëndrueshmëria e çmimeve gjatë zhvillimit të TE-së. Njësitë hidroenergjetike do të ndihmojnë OST-në për menaxhimin e kërkesave të sistemit dhe do të sigurojnë shumicën e shërbimeve ndihmëse për të arritur këtë objektiv.

3. KPGJ-ja mund të angazhohet në shkëmbime energjie elektrike me kompani të tjera jashtë vendit. ERE do të zgjidhë çdo mosmarrëveshje lidhur me faktin nëse një shkëmbim i veçantë (i vetëm ose së bashku me shkëmbime të tjera) është apo jo në interes të klientëve tarifore.

4. Kompania(të) që kryen aktivitetin e prodhimit, licencohet nga ERE për t'u angazhuar në aktivitete gjeneruese sipas nenit 34 të LSE-së dhe i shet OST-së (i) shërbime ndihmëse dhe (ii) energjinë për të përballuar humbjet teknike të energjisë elektrike në rrjetin transmetues.

Neni 9

Klientët tariforë dhe të kualifikuar

1. KSH, në përputhje me kontratën e furnizimit me energji elektrike që ka me klientët tariforë, do t'u sigurojë këtyre të fundit, furnizimin me energji elektrike me tarifa të rregulluara. Një klient tarifor nuk do të marrë pjesë në treg, po të mos jetë kualifikuar nga ERE sipas kritereve përkatëse.

2. Pasi të bëhet klient i kualifikuar, klienti për aq kohë sa do të jetë i tillë nuk do të jetë edhe klient tarifor. Konform nenit 45/1 dhe 48/1 të LSE-së, klientët e kualifikuar mund të furnizohen me energji elektrike vetëm nga furnizues të kualifikuar, vendas ose të huaj, të licencuar, të zgjedhur nga ai. KSH që u siguronte më parë shërbim klientëve që janë bërë klientë të kualifikuar nuk do të kenë më detyrime të shërbimit publik për këta klientë të kualifikuar sipas nenit 25 të LSE-së. Megjithatë një klient i kualifikuar mund të kontaktojë me KPGJ-në për energji elektrike rezervë apo emergjencë me terma dhe kushte që bien dakord midis palëve dhe që nuk paragjykojnë klientët tariforë. Një klient i kualifikuar mund të kthehet në sistem si klient tarifor vetëm pas miratimit të ERE-s dhe revokimit të statusit të klientit të kualifikuar nga ana e ERE-s. ERE mund të vendosë kushte të tilla për këtë kthim, nëse janë të nevojshme për të mbrojtur klientët tarifore nga çdo kosto e rritur e shkaktuar nga ky kthim.

3. KSH furnizon me energji elektrike klientët tariforë me tarifa të rregulluara nga ERE, energji elektrike të cilën e merr nga KPGJ-të me tarifa të rregulluara dhe importi nëpërmjet transmetimit të saj nga sistemi i transmetimit të OST-së. Përveç kësaj, KSH-ja mund të blejë energji direkt nga PVE e lidhur direkt me sistemin e shpërndarjes me tarifa të miratuara nga ERE. KSH-ja do t'i sigurojë OST-së gjithë informacionin e nevojshëm lidhur me kontratat që ka me PVE-të.

4. Të gjithë pjesëmarrësit e tregut, që kanë licenca të dhëna nga ERE do të plotësojnë dispozitat e RrT-ve. Çdo mosplotësim do të jetë objekt gjobe dhe sanksioneve sipas LSE-së.

Neni 10

Roli i ERE-s

ERE:

Miraton dhe modifikon rregullat e tregut të energjisë elektrike në përputhje me LSE-në.

a) Monitoron zbatimin e rregullave dhe procedurave në mënyrë transparente dhe jo-diskriminuese të miratuara sipas LSE-së për dhënien, modifikimin dhe revokimin e licencave të pjesëmarrësve të tregut.

b) Miraton një metodologji tarifash të transmetimit të gjenerimit dhe shpërndarjes të bazuar në kosto që siguron akses jodiskriminues.

c) Shqyrton dhe miraton marrëveshjet e hartuara nga palët që janë pjesë e strukturës së tregut dhe operimit të tij si më poshtë:

i) Marrëveshja vjetore e rregulluar e transmetimit të energjisë elektrike mes KPGJ-së dhe OST-së, sipas kërkesës së KPGJ-së;

ii) Marrëveshjet e rregulluara vjetore për shërbimet ndihmëse ndërmjet OST-së dhe KPGJ-ve, sipas kërkesës së OST-së;

iii) Marrëveshjet e rregulluara të shërbimit të transmetimit me tarifa të rregulluara të transmetimit ndërmjet çdo pjesëmarrësi tregu që kërkon këtë shërbim mbi baza jodiskriminuese;

iv) Marrëveshja e shërbimit të konsulencës lidhur me kompensimin që i jep KSH–ja OST–së, për shërbimin që OST-ja i jep në procesin e sigurimit të furnizimit me energji elektrike nga burimet e vendit dhe të huaja;

v) Marrëveshjet e rregulluara të eksporteve të licencuara të energjisë elektrike ndërmjet KPGJ-ve ose çdo prodhuesi të vendosur në Shqipëri dhe çdo blerësi të vendosur jashtë Shqipërisë.

d) Vlerëson aplikimet nga klientët tariforë që plotësojnë nivelin e kërkuar të konsumit për t'u bërë klientë të kualifikuar sipas LSE-së.

e) Vlerëson aplikimet nga prodhuesit e energjisë elektrike që kërkojnë statusin e prodhuesit të privilegjuar të energjisë elektrike ("PP") sipas nenit 38 të LSE-së. Mënyra, kohëzgjatja, termat dhe kushtet sipas të cilave OST-ja mund t'u japë trajtim prioritar dispeçerues PPE-ve janë përcaktuar në Kodin e Operimit të Rrjetit.

f) Licencon ndërtimin dhe operimin e PVE-ve, PP-ve dhe PKE-ve sipas LSE-së dhe rregullave transparente e jodiskriminuese të licencimit të adoptuara nga ERE.

j) Vlerëson dhe miraton marrëveshjet për blerje dhe shitje të energjisë, midis çdo PPE ose PKE të licencuar që ka kapacitet më të madh se 5 MW dhe kompanive që kanë aktivitetin e shpërndarjes, që këtë energji e planifikon për shitje të mëtejshme te klientët tariforë. Ky vlerësim do të marrë si duhet në konsideratë parimet e planifikimit me kosto të ulët, nevojat e Shqipërisë për diversitet të lëndëve djegëse dhe siguri të furnizimit. Ky vlerësim do të reflektojë rekomandimet e MTT-së që nevojat për energji elektrike të Shqipërisë përtej kapacitetit ekzistues hidroenergjetik të plotësohen me metodën e furnizimit të balancuar, e cila realizohet kryesisht me kontrata PPA-ve afatshkurtra, afatmesme dhe afatgjata të përshtatshme në mënyrë të tillë që shuma e të gjithë këtyre PPA-ve të mos kalojë një të tretën e nevojave vjetore për energji të Shqipërisë. Kufizimi prej një të tretën do të vlerësohet periodikisht nga ERE për të përcaktuar nëse vazhdon të reflektojë një balancë të mirë.

k) Zgjidh të gjitha mosmarrëveshjet ndërmjet pjesëmarrësve të tregut dhe ndërmjet pjesëmarrësve të tregut dhe klientëve tariforë, përfshirë këtu çdo mosmarrëveshje lidhur me aksesin në sistemin e transmetimit. Kjo dispozitë nuk ka për qëllim kufizimin e palëve për t'i zgjidhur mosmarrëveshjet nëpërmjet arbitrazhit apo gjykatës.

KAPITULLI III
OPERIMET BAZË TË TREGUT PËR PËRSHTATJEN E NGARKESËS ME BURIMET

Neni 11
Viti në avancë: Krijimi i tregut vjetor të energjisë

1. OST-ja do të kryejë çdo vit një studim për operimin e parashikuar të sistemit elektroenergjetik në vitin në avancë (Studimi vjetor). Ky studim do të përfundohet dhe do të jetë në formë dhe përmbajtje sipas përcaktimeve të Kodit të Sistemit të Transmetimit. Studimi do të bazohet në bazë të informacioneve të siguruara nga pjesëmarrësit e TE, të përshkruara në shtojcën A të këtyre rregullave dhe duhet të përmbajë edhe:

- parashikimin e kërkesës në terësi për energji elektrike për çdo muaj dhe vit në bazë të informacioneve të KSh-së dhe KK-së;

- parashikimin e ndërprerjeve (kufizimeve) të energjisë elektrike për çdo muaj dhe vit sipas planeve të ndërprerjeve të hartuara nga KSh-së dhe KK-së;

- parashikimin e pikut të ngarkesës në transmetim (pra deri në nivelin 110 kV në pikat ku lidhen rrjetat shpërndarëse të KSh-së) për çdo muaj, në bazë të informacioneve të KSh-së dhe KK-së, në bazë të ngarkesave pik të parashikuara nga KSh për çdo zbarrë 110 kV dhe koeficientëve të njëkohshmërisë të paraqitura prej tyre;

- parashikimin e grafikëve të përafërt të ngarkesave të sistemit në bazë të grafikëve të përafërta të ngarkesave për çdo zbarrë 110 kV, për çdo muaj;

- planifikimin e prodhimit të energjisë elektrike në tërë sistemin në bazë të informacioneve të

KPGj dhe PPE dhe prodhuesve të tjerë;

- duke marrë në konsideratë rëndësinë e prodhimit nga kaskada e lumit Drin, OST bën verifikimin e informacionit të KPGj për prodhimin nga kjo kaskadë, duke planifikuar dhe verifikuar njëkohësisht edhe nivelin në liqenin e Fierzës për çdo muaj të vitit dhe e konsulton atë vazhdimisht me KGjP;

- parashikimin dhe programet për importet dhe eksportet e energjisë elektrike në bazë të informacioneve të pjesëmarrësve në treg;

- parashikimin e konsumit për nevojat vetjake të nënstacioneve, si dhe humbjet e energjisë elektrike në tërë rrjetin transmetues që operon;

- parashikimin dhe analizat e shërbimeve ndihmëse të kërkuara përgjatë vitit në avancë lidhur më kërkesën që prodhuesit të ofrojnë rezervat e duhura për rregullimin primar, sekondar dhe terciar të fuqisë aktive dhe frekuencës;

- parashikimin e energjisë reaktive për të pasur gjatë gjithë vitit një profil të niveleve të tensionit brenda normave të lejuara në të gjithë sistemin transmetues;

- parashikimin e nevojave për energji balancuese për të mbuluar devijimet e mundshme gjatë çdo muaji dhe viti;

- projektplanin për marrjen e shërbimeve ndihmëse gjatë vitit në avancë;

- vlerësimin e operimeve në terma të sigurisë dhe të qëndrueshmërisë së Sistemit Elektroenergjetik;

- vlerësimin e masave paraprake që do të duhet të ndërmarrë gjatë tërë vitit për respektimin e për arritjen e niveleve të mjaftueshme të qëndrueshmërisë dhe të sigurisë për sistemin shqiptar të energjisë sipas udhëzuesit të UCTE-së;

- vlerësimin dhe parashikimin (ex-ante) të pjesëmarrjes në kompensimin e transitimeve midis TSO (inter TSO compesation mechanizem) të rajonit, si dhe parashikon fondin e duhur për të mbuluar këtë shërbim (fondi CBT);

- vlerësimin dhe parashikimin për linjat e interkoneksionit të kapacitetit transmetues neto (Net Transfer Capacity), të kapacitetit transmetues të disponueshëm (Available Tranfer Capacity), si dhe mundësitë e kapacitetit transmetues të alokuar (Alocated Transfer Capacity) sipas një vlerësimi paraprak për çdo pjesëmarrës në treg.

2. OST-ja ka përgjegjësinë për planifikimin dhe realizimin e programit të planifikuar deri në nivelin e sistemit të transmetimit. OST-ja do të jetë përgjegjëse edhe në planifikimin dhe realizimin e shërbimeve të mëposhtme:

a) Shërbimet ndihmëse

Bazuar në informacionin nga studimi vjetor, OST-ja do të përgatisë një parashikim të nevojave të shërbimeve ndihmëse vjetore për vitin në avancë dhe jo më vonë se 1 dhjetori i vitit aktual përpara vitit në avancë me të cilin lidhet, do t'ua paraqesë këto parashikime ERE-s, KPGj-së, PGC-së dhe pjesëmarrësve të tjerë të tregut.

KPGj-ja do t'ia shesë këtë shërbim OST-së në bazë të një marrëveshjeje vjetore për blerjen nga OST-ja të shërbimeve ndihmëse (Marrëveshja e shërbimeve ndihmëse vjetore "MSNV") nga njësitë ekzistuese hidroenergjetike teknikisht të afta për t'i sigurar këto shërbime dhe me çmime që nuk kalojnë çmimet maksimale të rregulluara të vendosura nga ERE për këto shërbime.

OST-ja mund t'u kërkojë gjithashtu pjesëmarrësve të tjerë të tregut që prodhojnë ose furnizojnë energji elektrike në tregun shqiptar (PPE, furnizuesit e kualifikuar, furnizuesit e jashtëm) dhe që sigurojnë një pjesë të arsyeshme të shërbimeve ndihmëse.

b) Energjia balancuese

Bazuar në informacionin nga studimi vjetor, OST-ja do të përgatisë një parashikim të nevojave për energji balancuese vjetore për vitin në avancë dhe jo më vonë se 1 dhjetori i vitit aktual për vitin në avancë, do t'ia paraqesë ketë parashikim ERE-s dhe pjesëmarrësve të tregut.

KPGj-ja do t'ia ofrojë këtë energji balancuese OST-së në bazë të një marrëveshjeje vjetore për ofrimin nga KPGj-ja të energjisë balancuese (Marrëveshja e energjisë balancuese vjetore "MEBV") nga njësitë ekzistuese hidroenergjetike teknikisht të afta për t'i sigurar këto shërbime dhe me çmime që nuk kalojnë çmimet maksimale të rregulluara të vendosura nga ERE për këto shërbime.

OST-ja mund t'u kërkojë gjithashtu pjesëmarrësve të tjerë të tregut që prodhojnë ose të furnizojnë energji elektrike në tregun shqiptar (PPE, furnizuesit e kualifikuar, furnizuesit e jashtëm etj.) dhe që sigurojnë një pjesë të arsyeshme të energjisë balancuese.

c) Shërbimi i CBT (Cross Border Trading)

Bazuar në informacionin nga studimi vjetor, OST-ja do të përgatisë një parashikim të nevojave për kompensimin vjetor (ex-ante) të transitimeve ndërmejt TSO (inter TSO compesation mechanizëm) të rajonit, si dhe të parashikojë fondin e duhur për të mbuluar këtë shërbim (fondi CBT) për vitin në avance. Jo më vonë se 1 dhjetori i vitit aktual për vitin në avance, do t'ia paraqesë ketë parashikim ERE-s dhe pjesëmarrësve të tregut.

Për këtë shërbim të OST-së do të ketë një marrëveshje vjetore për kompensimin e transitimeve (Marrëveshja e CBT vjetore "MCBTV") me TSO-të e rajonit dhe do t'ia paraqesë ERE-s për miratim. OST-ja do t'ia shesë këtë shërbim pjesëmarrësve të tregut.

d) Shërbimi i alokimit të kapacitetit të interkoneksionit

Bazuar në informacionin nga studimi vjetor, OST-ja do të përgatisë një parashikim të aftësisë vjetore të interkoneksionit lidhur me kapacitetin transmetues, kapacitetit transmetues neto (Net Transfer Capacity), të kapacitetit transmetues të disponueshëm (Available Transfer Capacity), si dhe mundësitë e kapacitetit transmetues të alokuar (Alocated Transfer Capacity) për vitin në avancë dhe jo më vonë se 1 dhjetori i vitit aktual për vitin në avancë, do t'ia paraqesë këtë parashikim ERE-s dhe pjesëmarrësve të tregut.

OST-ja do t'ia shesë këtë shërbim pjesëmarrësve të tregut në bazë të një marrëveshjeje vjetore për sigurimin e kapaciteteve të interkoneksionit (Marrëveshja e alokimit të kapacitetit të interkoneksionit vjetor "MAKIV").

OST-ja do t'u kërkoje gjithashtu pjesëmarrësve të tregut që ofertojnë për të marrë (blerë) kapacitet interkoneksioni dhe me pas do t'u ofrojë këtyre këtë shërbim gjithmonë duke pasur parasysh përparësitë e mëposhtme:

a) Plotësimin e kapacitetit të kërkuar nga pjesëmarrësit e tregut të licencuar nga ERE, për llogari të konsumatorëve tariforë, e cila sipas nenit 25 të LSE-së realizohet si shërbim publik;

b) Pasi të plotësohet detyrimi i parashikuar në pikën (a) më sipër, bëhet plotësimi i kapacitetit të kërkuar nga pjesëmarrësit e tregut të licencuar nga ERE për llogari të klientëve të kualifikuar duke e ndarë atë në mënyrë transparente dhe jodiskriminuese;

c) Pas përmbushjes së detyrimit të shprehur në pikën (a) më sipër, nëse kapacitetet e alokuara nuk plotësojnë kërkesat e pjesëmarrësve të tregut të licencuara nga ERE për llogari të klientëve të kualifikuar, atëherë OST organizon ankand për këto kapacitete me rregulla transparente të miratuara nga ERE.

3. KSh-ja ka përgjegjësinë për planifikimin dhe realizimin e programit të planifikuar deri në nivelin e sistemit të shpërndarjes.

Bazuar në informacionin nga studimi vjetor, OST-ja do të përgatisë jo më vonë se 1 dhjetori i vitit aktual për vitin në avancë, një parashikim vjetor të nevojave për energji dhe do t'ia paraqesë ketë parashikim ERE-s, KPGJ-së dhe pjesëmarrësve të tjerë të tregut.

Bazuar në informacionin nga studimi vjetor, OST-ja do të përgatisë jo më vonë se 1 dhjetori i vitit aktual për vitit në avancë, një parashikim vjetor të prodhimit të energjisë elektrike dhe do t'ia paraqesë këtë parashikim ERE-s, KSh-së dhe pjesëmarrësve të tjerë të tregut.

KPGj-ja do t'i ofrojë energji elektrike kompanisë (ve) të shpërndarjes në bazë të një marrëveshjeje vjetore për blerjen e energjisë elektrike nga KSh-ja, me çmime të rregulluara të bazuara në kostot e prodhimit. KSh-ja do të jetë e detyruar ta blejë ketë energji elektrike brenda maksimumeve (Pmax) dhe minimumeve (Pmin) të rekomanduara të vendosura në marrëveshjen vjetore të furnizimit me energji ("MVFU"), për të furnizuar të gjithë klientët tariforë që u shërben.

KPGj-ja është e detyruar t'ia shesë energjinë elektrike KSh-së me çmime të rregulluara, përveç rasteve kur KPGj-ja me miratimin e ERE-s është kontraktualisht e angazhuar ta shesë këtë energji elektrike në tregun e eksportit, sipas kufizimeve të LSE, akteve të tjera nënligjore dhe licencës së saj.

KSh-ja mund të blejë energji elektrike shtesë nga PPE-të, PVE-të etj.

KSh-ja mund të blejë energji elektrike shtesë nga furnizuesit e kualifikuar vendas dhe të huaj dhe nga furnizuesit e jashtëm, nëse energjia e blerë nga KPGj-ja është e pamjaftueshme për të plotësuar nevojat për energji të gjithë klientëve tariforë që u shërben. OST-ja do të ndihmojë dhe konsultojë KSh-në në veprimtarinë saj për sigurimin e energjisë elektrike për të mbuluar kërkesën e klientëve tariforë, në marrëveshjet e KSh-së me furnizuesit e kualifikuar vendas dhe të huaj dhe nga furnizuesit e jashtëm.

4. Në stadin fillestar të TE-së, marrëveshja midis KPGj-së dhe OST-së për sigurimin e shërbimeve ndihmëse dhe marrëveshja midis OST-së dhe KSh-së për ndihmën dhe konsulencën për sigurimin e energjisë elektrike për të plotësuar kërkesën e klientëve tariforë, do të duhet të kompensojnë njëra-tjetrën.

(Kjo vjen nga fakti që aktualisht sh.a. KESH nuk është ndarë në kompani të veçanta gjenerimi dhe shpërndarje. Me maturimin e tregut do të jetë e përshtatshme të zhvillohen marrëveshje dypalëshe direkte, ligjërisht të detyrueshme mes KPGj-së dhe KSh-së, si dhe OST-së kur këto funksione të jenë ndarë plotësisht nga ana funksionale, financiare dhe ligjore.)

Neni 12
Muaji në avancë

1. Jo më vonë se 10 ditë para një muaji të caktuar në vitin në avancë, QKD-ja do të hartojë një plan mujor operimi për operimin e sistemit elektroenergjetik të bazuar në informacionet e azhurnuara mujore të siguruar nga pjesëmarrësit e tregut.

2. Plani mujor i operimit për muajin në avancë do të përmbajë:

- kërkesën për energji elektrike dhe mbulimi i tyre nga prodhimi vendas;
- kurbat e parashikuara të ngarkesës tipike javore dhe ditore gjatë muajit për ditët e punës, ditët e shtuna e të diela dhe ditët e festave, si dhe kurbat tipike mujore të ngarkesës;
- planin ditor dhe mujor të ndërprerjeve (kufizimeve) të furnizimit me energji elektrike;
- verifikimin e nivelit të liqenit të Fierzës;
- energjinë e importuar të programuar;
- planin mujor të ndërprerjeve të programuara të gjeneratorëve;
- planin për shërbime ndihmëse gjatë muajit;
- vlerësimin e operimeve të parashikuara në terma të qëndrueshmërisë dhe sigurisë së sistemit elektroenergjetik dhe masat e parashikuara gjatë muajit për të ruajtur sigurinë dhe qëndrueshmërinë sipas nevojës.

3. Për të ndihmuar OST-në në përgatitjen e planit mujor të operimit, pjesëmarrësit e tregut (KPGj-ja, KSh-ja, klientët e kualifikuar, furnizuesit e kualifikuar vendas dhe të huaj, furnizuesit e jashtëm, PPE etj.), që marrin shërbim në nivel transmetimi, do t'i japin OST-së informacionin e kërkuar të specifikuar në shtojcën A bashkëngjitur, jo më vonë se 20 ditë para fillimit të muajit për të cilin është përgatitur plani. Siguruesit e informacionit të kërkuar do të njoftojnë menjëherë me shkrim OST-në për ndryshimet materiale në informacionin e dhënë.

Neni 13
Java në avancë

1. OST-ja do të hartojë një plan javor në orën 12:00 a.m. të ditës së fundit të punës (e premte) para javës në avancë. Java e energjisë do të fillojë të hënën në orën 00:00 dhe do të mbarojë të dielën në orën 24:00. Plani javor do të caktojë sasinë e energjisë që nevojitet nga KPGj-ja për çdo orë të javës së energjisë, për shërbimet ndihmëse, shërbimet balancuese dhe furnizimin me energji, bazuar në informacionin më të fundit të dhënë nga pjesëmarrësit e tregut dhe çdo përmirësim dhe azhurnim të këtij informacioni të dhënë nga pjesëmarrësit e tregut.

2. OST-ja do të hartojë për çdo ditë planin e njësive gjeneruese që do të vihen në punë në çdo orë të ditës; kjo do të jetë parashikuese dhe do të zbatohet plotësisht gjatë planifikimit ditor për çdo orë të ditës.

3. Përveç energjisë që KPGj-ja ka angazhuar të furnizojë KSh-në, shuma totale mund të përfshijë edhe energji shtesë nga njësitë gjeneruese hidrike. Megjithatë, përcaktimi i energjisë shtesë nga njësitë ekzistuese hidroenergjetike nuk duhet të cenojë (i) angazhimet e bëra nga KGj-ja për shkëmbimet e energjisë dhe eksportet (nëse është e licencuar nga ERE për këtë qëllim), (ii) dispozitat e udhëzuesit të UCTE-së mbi rregullimin e fuqisë dhe frekuencës dhe (iii) menaxhimin e kujdesshëm të niveleve të liqeneve nga KPGj-ja.

4. Plani javor do të përmbajë skedulin e energjisë së importuar dhe burime të tjera të parashikuara që do të dispeçerohen mbi baza ekonomike dispeçerimi nga QKD-ja gjatë javës së

energjisë për të përballuar ngarkesën e parashikuar.

5. Plani javor i skedulimit të importit i deklaruar nga pjesëmarrësit e tregut, nuk mund të ndryshojë gjatë ditëve të javës së energjisë. Çdo shmangie nga programi javor do të konsiderohet devijim dhe pjesëmarrësit e tregut që e kanë kryer këtë devijim do të paguajnë një sanksion që parashikohet në marrëveshje të palëve dhe që do të jetë i njëjtë për të gjithë pjesëmarrësit e tregut që kryejnë devijime.

6. Shmangiet nga programi javor në masën +/- 5% do të konsiderohen si devijime për të cilat pjesëmarrësit e tregut nuk paguajnë sanksione, por ata janë të detyruar që për javën pasardhëse të planifikojnë rregullimin e këtyre devijimeve.

7. OST do të kryejë për çdo javë në avancë programin lidhur me alokimin e kapacitetit të nevojshëm për linjat e interkoneksinit për çdo pjesëmarrës në treg të cilët kanë program furnizimi nga furnizuesit e kualifikuar vendas ose të huaj dhe nga furnizuesit e jashtëm. Llogaritja e kapaciteteteve të alokuara (Alocated Tranfer Capacity) bëhet mbi bazën e kapacitetit disponibël (Available Transfer Capacity) të deklaruar nga OST si llogaritje nga Net Tranfer Capacity.

8. Plotësimi i nevojave të pjesëmarrësve të tregut lidhur me kapacitetet e kërkuara, bëhet duke pasur parasysh përparësinë e mëposhtme:

a) Plotësimin e kapacitetit të kërkuar nga pjesëmarrësit e tregut të licencuar nga ERE, për llogari të konsumatorëve tariforë, e cila sipas nenit 25 të LSE realizohet si shërbim publik;

b) Pasi të plotësohet detyrimi i parashikuar në pikën (a) më sipër, bëhet plotësimi i kapacitetit të kërkuar nga pjesëmarrësit e tregut të licencuar nga ERE për llogari të klientëve të kualifikuar duke e ndarë atë në mënyrë transparente dhe jodiskriminuese.

c) pas përmbushjes së detyrimit të shprehur në pikën (a) më sipër, nëse kapacitetet e alokuara nuk plotësojnë kërkesat e pjesëmarrësve të tregut të licencuara nga ERE për llogari të klientëve të kualifikuar, atëherë OST organizon ankand për këto kapacitete me rregulla transparente të miratuara nga ERE.

Neni 14
Dita në avancë dhe axhustimet ditore

1. Në vijim të përgatitjeve të planit javor për javën e energjisë, OST-ja bën azhurnime ditore të programit të prodhimit dhe importit për të plotësuar kërkesat ditore për energji.

2. Në rast se parashikimet e përmirësuara të ditës në avancë tregojnë se nevojitet energji elektrike shtesë më tepër nga sa mund të sigurohet nga gjithë burimet e disponueshme, përfshirë PPE-të dhe pjesëmarrësit e tjerë të tregut, KSH-ja do të aplikojë ndërprerje të nevojshme të energjisë elektrike për t’a mbajtur sistemin elektroenergjetik të balancuar. Përveç kësaj, ndërprerjet e energjisë mund të jenë gjithashtu të nevojshme nëse ngarkesat gjatë një dite të dhënë i kalojnë parashikimet e ditës në avancë.

KAPITULLI IV
RREGULLA TË TJERA PËR OPERIMIN E TREGUT

Neni 15
Dispeçerimi dhe kontrolli i sistemit

1. OST-së do t’i kërkohet të mbajë një regjistër e të gjithë kontratave që kanë pjesëmarrësit e tregut me njëri-tjetrin për blerjen dhe shitjen e energjisë elektrike në mënyrë që OST-ja të mund ta operojë sistemin e transmetimit në mënyrë të qëndrueshme dhe efiçente.

2. Në rast emergjence në sistem, OST-ja mund të nxjerrë udhëzime për dispeçerimin emergjent për gjithë facilitetet gjeneruese në përputhje me procedurat e identifikuara në Kodin e Operimit të Rrjetit.

Neni 16
Procedurat e operimit

1. Procedurat tipike të operimit që duhen ndjekur nga OST-ja do të jenë si më poshtë:

a) Dita e operimit

Gjatë ditës së operimit, OST-ja do të dispeçerojë në mënyrë ekonomike njësitë e gjenerimit të KPGJ-së, PVE-ve dhe PPE-ve për të plotësuar ngarkesat dhe do të zbatojë transaksionet e programuara të importit dhe eksportit, bazuar në planin javor të korrigjuar gjatë periudhës së ditës në avancë.

OST-ja do të ndjekë programin e dispeçerimit, të azhurnuar për të përballuar ngjarjet e papritura në sistem si stakimi i njësive të gjenerimit ose rënia e linjave të transmetimit. Për ta mbajtur sistemin e transmetimit të qëndrueshëm, OST-ja do të ridispeçerojë gjithë njësitë gjeneruese.

OST-ja do t'i trajtojë gjithë ngjarjet e paparashikuara në përputhje me Kodin e Operimit të Rrjetit për të siguruar vendime transparente mbi dispeçerimin.

b) Dita pas ditës së operimit

Në ditën pas ditës së operimit, OST-ja do të kontrollojë për saktësi gjithë të dhënat orarë të matjes nga gjeneratori, kufiri dhe ngarkesa. Pas kontrollit të të dhënave, OST-ja do të shpërndajë pasqyra ditore që përmbajnë të dhënat që u nevojiten KPGJ-së, PVE-ve, PPE-ve, furnizuesve të jashtëm, furnizuesve të kualifikuar (vendas ose të huaj) dhe klientëve të kualifikuar për të llogaritur detyrimet përkatëse sipas kontratave respektive dypalëshe.

Neni 17

Fluksi i fondeve dhe i likuidimeve

1. Fluksi i fondeve për pjesëmarrësit kryesorë të tregut përmblidhet si vijon:

a) OST-ja

i) Të pagueshme:

OST-ja do të paguajë fatura nga KPGJ-ja, PVE-të, PPE-të, furnizuesit e kualifikuar (vendas ose të huaj) dhe furnizuesit e jashtëm për shërbimet ndihmëse dhe/ose për energjinë balancuese;

ii) Për t'u marrë:

a) KSH, furnizuesit e kualifikuar (vendas ose të huaj) dhe klientët e kualifikuar (kur është rasti) do t'a paguajnë OST-në për pjesën e tyre proporcionale të shërbimeve ndihmëse;

b) Pjesëmarrësit e tregut që marrin shërbime transmetimi do të paguajnë pagesat e transmetimit të llogaritura sipas tarifave jodiskriminuese të bazuara në kosto të përfshira në Marrëveshjen e shërbimeve të transmetimit të miratuara nga ERE-ja.

c) Furnizuesit e kualifikuar apo klientët e kualifikuar në rastin kur këta të fundit kanë kontratë me OST-në për shërbimet e transmetimit, do t'i paguajnë OST, tarifën e CBT sipas pjesës së tyrë proporcionale për energjinë e marrë nga furnizues të jashtëm apo furnizuesit e kualifikuar në rastin e klientëve të kualifikuar.

d) Furnizuesit e kualifikuar apo klientet e kualifikuar në rastin kur këta të fundit kanë kontratë me OST-në për shërbimet e transmetimit, do t'i paguajnë OST-së, tarifën e alokimit të kapacitetit në linjat e interkoneksionit (Alocated Transfer Capacity) sipas pjesës së tyre proporcionale për fuqinë e alokuar në favor të tyre.

b) Kompania publike e gjenerimit:

(i) Të pagueshme:

a) KPGJ-ja do t'i paguajë OST-së për shërbimet e transmetimit të siguruara sipas tarifave të miratuara nga ERE-ja;

b) KPGJ-ja do t'i paguajë PPE-ve apo pjesëmarrësve të tjerë të tregut për blerjet e energjisë elektrike ekonomike.

(ii) Për t'u marrë:

a) OST-ja do ta paguajë KPGJ-në për shërbimet ndihmëse;

b) KSH-ja do ta paguajë KPGJ-në për energjinë elektrike me tarifa të rregulluara;

c) Furnizuesit e kualifikuar, klientët e kualifikuar dhe furnizuesit e jashtëm do të paguajnë KPGJ-në për energjinë elektrike të shitur atyre për aq sa këto shitje janë të lejuara.

c) KSH:

i) Të pagueshme:

a) KSH-ja do t'i paguajë KPGJ-së për gjithë energjinë elektrike të blerë për klientët tariforë në bazë të energjisë së shpërndarë në sistem nga KPGJ-ja;

b) KSH-ja do t'u paguajë PVE-ve, PPE-ve, furnizuesit e kualifikuar dhe furnizuesit e jashtëm

për energjinë elektrike të blerë;

c) KSH-ja do t'i paguajë OST-së për shërbimin e transmetimit për shkëmbimin e energjisë elektrike sipas një tarife transmetimi të bazuar në kosto të miratuar nga ERE-ja.

ii) Për t'u marrë:

a) Klientët tariforë do t'i paguajnë KSH-së për energjinë elektrike të furnizuar atyre, me tarifa të bazuara në kosto dhe jodiskriminuese të miratuara nga ERE-ja.

b) Furnizuesit e kualifikuar, apo klientët e kualifikuar, kur është rasti, do të paguajnë KSH-në për shërbimin e shpërndarjes, kur kjo e fundit kërkohet nga ata.

Faturimi do të realizohet konform legjislacionit në fuqi. Furnizimi me energji dhe pagesa e saj nga klientët tariforë do të realizohet sipas kushteve të vendosura në kontratën dypalëshe.

KAPITULLI V
INFORMACIONI I TREGUT

Neni 18
Aksesi në informacionin e tregut

OST-së do t'i verë në dispozicion çdo pjesëmarrësi tregu, sipas kërkesës, çdo informacion që ka të bëjë me operimin e tregut, si jokonfidencial ose komercialisht jo i ndjeshëm dhe mund të caktojë një pagesë të arsyeshme për të mbuluar koston për sigurimin e informacionit.

Neni 19
Varësia nga informacioni i saktë

Për të siguruar një treg efiçent, OST-së duhet t'i sigurohet informacion i plotë dhe i saktë nga pjesëmarrësit e tregut.

SHTOJCA A

INFORMACIONI I VITIT NË AVANCË

Informacioni nga kompania (të) e shpërndarjes (KSh)

- parashikimi i kërkesës për energji elektrike vjetore e ndarë kjo për çdo muaj dhe sipas zonave të shpërndarjes;
- parashikimi i ndërprerjeve (kufizimeve nëse do të ketë) të energjisë elektrike e ndarë kjo për çdo muaj dhe sipas zonave;
- parashikimi i kurbave tipike ditore të ngarkesës për ditët e punës, të shtunat, të dielat dhe ditët e festave, e paraqitur kjo për çdo muaj dhe sipas sezonit (kurbat e ngarkesës do të duhet të jepen veçmas për fuqinë aktive dhe reaktive duke dhënë njëkohësisht edhe faktorin e ngarkesës së parashikuar në bazë të kurbave të vijueshmërisë mujore);
- parashikimi i ngarkesave pik në pikat respektive të lidhjes me sistemin e transmetimit (në çdo zbarrë 110 kV), si dhe koeficientin e njëkohshmërisë në orët e pikut të ngarkesave, e paraqitur kjo për çdo muaj;
- parashikimi i bilanceve të energjive aktive dhe reaktive në pikat respektive të lidhjes me sistemit e transmetimit, e ndarë kjo për çdo muaj dhe sipas zonave, si dhe i faktorit të fuqisë (cos φ);
- parashikimi i pjesë së kërkesës për energji elektrike që do të furnizohet direkt në sistemin e shpërndarjes nga gjeneratorët (prodhuesit) e lidhur direkt në të, duke marrë informacion nga prodhuesit si KPGj, PPE, PP, PVE dhe PKE;
- parashikimi i përafërt i mundësisë së mbulimit të kërkesës me energji elektrike të prodhuar në vend nga KPGj, si dhe detyrimet për importin e energjisë elektrike e ndarë kjo në muaj, si dhe të gjitha detyrimet kontraktuale për marrjen e energjisë elektrike nga prodhuesit e licencuar si PPE apo ata të lidhur në rrjetin e shpërndarjes;
- parashikimi i konsumit efektiv të energjisë elektrike, i strukturuar si konsum nga konsumatorët tariforë të lidhur në TL dhe TU, nga muaji i 6-të e deri në muajin e 12- të të vitit n dhe

në muajt e vitit n+1, si dhe analiza dhe vlerësimi i konsumit faktit sipas muajve për vitin n–1 dhe nga muaji i 1-rë deri në muajin e 5-të të vitit n;

- parashikimi i konsumit të energjisë elektrike për të mbuluar humbjet dhe konsumin vetjak të mbajtësit të licencës për shpërndarjen e energjisë elektrike (pra konsumin vetjak të nënstacioneve, konsumin e zyrave, magazinave e të fasiliteteve të tjera të të licencuarit) nga muaji i 6-të deri në muajin e 12-të të vitit n dhe muajve të vitit n+1, si dhe analiza dhe vlerësimi i konsumit faktik sipas muajve për vitin n–1 dhe për muajt nga i 1-ri deri në të 5-n e vitit n.

Informacioni nga furnizuesit e kualifikuar (vendas ose të huaj)

- parashikimi i furnizimit me energji elektrike vjetore e ndarë kjo për çdo muaj dhe sipas klientëve të kualifikuar;
- parashikimi i kërkesës për energji reaktive e ndarë kjo për çdo muaj dhe sipas klientëve të kualifikuar;
- parashikimi i kurbave tipike ditore të ngarkesës për energjinë e furnizuar te klientët e kualifikuar, për çdo muaj dhe për çdo pikë furnizimi;
- parashikimi i pjesës së furnizimit me energji elektrike (për aq sa kjo lejohet nga LSE apo aktet e tjera nënligjore të dala në zbatim të tij) që do të kontraktohet direkt me gjeneratorët (prodhuesit) e vendit KPGj, PPE, PP,PVE dhe PKE, si dhe detyrimet kontraktuale të ndara këto për çdo muaj;
- parashikimi i pjesës së furnizimit me energji elektrike që do të furnizohet nga importi, si dhe detyrimet kontraktuale për importin me furnizuesit e jashtëm, të paraqitura këto të ndara çdo muaj;
- parashikimin e grafikëve të fuqisë së importuar të ndara në muaj;
- parashikimi i pjesëmarrjes së sasisë së fuqisë së importuar për kërkesën e tij në kapacitetin e disponueshëm të linjave të interkoneksionit, mënyrën se si kjo pjesëmarrje kërkohet të kontraktohet me OST-në, si dhe kërkesën për blerjen e kapacitetit që duhet alokuar për të (Furnizuesin e Kualifikuar);

INFORMACIONI NGA KLIENTËT E KUALIFIKUAR

- parashikimi i kërkesës për energji elektrike vjetore e ndarë kjo për çdo muaj dhe sipas pikave të lidhjes në sistemin e shpërndarjes apo të transmetimit;
- parashikimi i kërkesës për energji reaktive e ndarë kjo për çdo muaj dhe sipas pikave të lidhjes në sistemin e shpërndarjes apo të transmetimit, si dhe i faktorit të fuqisë (cos φ);
- parashikimi i ndërprerjeve (kufizimeve nëse do të ketë) të energjisë elektrike e ndarë kjo për çdo muaj dhe sipas pikave të lidhjes;
- parashikimi i kurbave tipike ditore të ngarkesës për ditët e punës, të shtunat, të dielat dhe ditët e festave, e paraqitur kjo për çdo muaj dhe sipas pikave të lidhjes (kurbat e ngarkesës do të duhet të jepen veçmas për fuqinë aktive dhe reaktive duke dhënë njëkohësisht edhe faktorin e ngarkesës së parashikuar në bazë të kurbave të vijueshmërisë mujore) ;
- parashikimi i ngarkesave pik në pikat e lidhjes me sistemin e shpërndarjes apo të transmetimit, si dhe koeficientin e njëkohshmërisë në orët e pikut të ngarkesave, e paraqitur kjo për çdo muaj;
- parashikimi i bilanceve të energjive aktive dhe reaktive në pikat respektive të lidhjes me sistemin e shpërndarjes apo të transmetimit, e ndarë kjo në muaj dhe sipas pikave të lidhjes;
- parashikimi i pjesës së kërkesës për energji elektrike që do të furnizohet direkt nga gjeneratorët (prodhuesit) e vendit (për aq sa kjo lejohet nga LSE dhe aktet e tjera nënligjore të dala në zbatim të tij) KPGj, PPE, PP, PVE dhe PKE, si dhe detyrimet kontraktuale të ndara këto për çdo muaj;
- parashikimi i pjesës së kërkesës për energji elektrike që do të furnizohet nga jashtë vendit (importi), si dhe detyrimet kontraktuale për importin ndaj furnizuesit të kualifikuar vendas apo të huaj, të paraqitura këto të ndara çdo muaj;
- parashikimin e grafikëve të fuqisë së importuar të ndara në muaj dhe sipas furnizuesve të kualifikuar (nësë ka detyrime kontraktuale me disa FK);
- parashikimi i pjesëmarrjes së sasisë së fuqisë të importuar për kërkesën e tij në kapacitetin e disponueshëm të linjave të interkoneksionit, mënyrën se si kjo pjesëmarrje kërkohet të kontraktohet me OST-në, si dhe kërkesën për blerjen e kapacitetit që duhet alokuar për të (klientin e kualifikuar). Ky paragraf vlen për rastin kur klienti i kualifikuar, ka kontratë për furnizimin me energji elektrike me furnizuesin e kualifikuar (vendas ose të huaj) deri në kufirin shqiptar dhe do të kërkojë shërbimin e transmetimit nga OST.

INFORMACION NGA KOMPANIA(TË) PUBLIKE GJENERUESE (KPGJ)

- planifikimin e prodhimit të energjisë elektrike nga kaskada e lumit Drin, duke planifikuar dhe verifikuar nivelin në liqenin e Fierzës, e ndarë në muaj dhe tërë vitin; planifikimi i prodhimit dhe i nivelit të liqenit të Fierzës do të përllogaritet me 90%, 75% dhe 50% të probabilitetit të ardhjes së prurjeve mujore në liqenin e Fierzës duke shfrytëzuar statistikën mbi prurjet shumëvjeçare;
- planifikimin e prodhimit të energjisë elektrike nga kaskada e Matit, kaskada e Bistricës dhe nga centralet e tjera hidrike dhe termike që zotëron dhe operon;
- planifikimin e disponibilitetit të njësive gjeneruese të centraleve që operon e ndarë kjo në muaj duke përcaktuar edhe skedulin e stakimeve të njësive gjeneruese për shkak të remonteve të ndryshme të vendosura prej tij, si dhe për ndërhyrjet e thella rehabilituese;
- planifikimin për çdo muaj të fuqive disponuese orare të çdo centrali dhe furnizon kurbat e aftësisë të çdo njësie gjeneruese për të parë mundësinë e gjenerimit të fuqive reaktive;
- planifikimin për çdo muaj të konsumit për nevojat vetiake dhe të humbjeve në transformatorët bllok të njësive gjeneruese, për çdo central;
- parashikimin e specifikave lidhur me kapacitetin e disponueshëm të njësive gjeneruese dhe centraleve për vitin n+1;
- parashikimin e mosdisponibilitetit (mosfunksionimit) të njësive gjeneruese për shkak të defekteve të paparashikuara (*forced outages*) duke e llogaritur këtë për çdo njësi gjeneruese si mesatare vjetore e orëve të mosdisponibilitetit të njësive gjeneruese, kundrejt orëve të punës shumarë vjetore sipas statistikave të pesë viteve parardhëse;
- parashikimin e mundësive që duhet të ofrojë për rregullimin primar të frekuencës (rregullimi i shpejtësisë) për çdo njësi gjeneruese, si dhe pjesëmarrjen e çdo njësie gjeneruese në rregullimin sekondar të fuqisë dhe frekuencës së sistemit elektroenergjetik;
- parashikimin e mundësive që duhet të ofrojë për sigurimin e rezervave për rregullimin primar, sekondar dhe terciar në sistemin elektroenergjetik ;
- parashikon dhe furnizon karakteristikat e mundshme të centralit për vitin n+1 në lidhje me mundësinë e rregullimit të tensionit dhe fuqisë reaktive, mundësinë e startimit të centralit nga burim i pavarur (*black start*), tarimet e mbrojtjes rele që kanë ndikim në operimin e sistemit elektroenergjetik etj;
- furnizon metodën e përdorur për shfrytëzimin efiçent dhe ekonomik të centraleve hidrike dhe termike që zotëron dhe operon, si dhe paraqet për çdo central koston e prodhimit të energjisë elektrike për çdo muaj dhe vjetor.

Informacion nga:

PRODHUESIT E PAVARUR TË ENERGJISË ELEKTRIKE (PPE)
PRODHUESIT ME KOGJENERIM TË ERNERGJISË ELEKTRIKE (PKE)
PRODHUESIT E PRIVILEGJUAR TË ENERGJISË ELEKTRIKE (PP) DHE PRODHUESIT E VEGJËL TË ENERGJISE ELEKTRIKE (PVE)

- Planifikimin e prodhimit të energjisë elektrike e ndarë në muaj dhe tërë vitin;
- Planifikimin e disponibilitetit të njësive gjeneruese të centraleve që operon e ndarë kjo në muaj, duke përcaktuar edhe skedulin e stakimeve të njësive gjeneruese për shkak të remonteve të ndryshme të vendosura prej tij;
- Planifikimin për çdo muaj të fuqive disponuese orare të çdo centrali dhe furnizon kurbat e aftësisë së çdo njësie gjeneruese për të parë mundësinë e gjenerimit të fuqive reaktive;
- Planifikimin për çdo muaj të konsumit për nevojat vetiake dhe humbjeve në transformatorët bllok të njësive gjeneruese, për çdo central;
- Parashikimin e specifikave lidhur me kapacitetin e disponueshëm të njësive gjeneruese dhe centraleve për vitin n+1;
- Parashikimin e mosdisponibilitetit (mosfunksionimit) të njësive gjeneruese për shkak të difekteve të paparashikuara (*forced outages*), duke e llogaritur këtë për çdo njësi gjeneruese si mesatare vjetore e orëve të mosdisponibilitetit të njësive gjeneruese kundrejt orëve të punës shumarë vjetore sipas statistikave të pesë viteve parardhëse;
- Parashikimin e mundësive që duhet të ofrojë për rregullimin primar të frekuencës (rregullimi i shpejtësisë) për çdo njësi gjeneruese, si dhe pjesëmarrjen e çdo njësie gjeneruese në rregullimin

sekondar të fuqisë dhe frekuencës së sistemit elektroenergjetik.

- Parashikimin e mundësive që duhet të ofrojë për sigurimin e rezervave për rregullimin primar, sekondar dhe terciar në sistemin elektroenergjetik;

- Parashikon dhe furnizon karakteristikat e mundshme të centralit për vitin n+1 në lidhje me mundësinë e rregullimit të tensionit dhe fuqisë reaktive, mundësinë e startimit të centralit nga burim i pavarur (*black start*), tarimet e mbrojtjes rele që kanë ndikim në operimin e sistemit elektroenergjetik etj.

- Furnizon metodën e përdorur për shfrytëzimin eficient dhe ekonomik të centralit (hidrik apo termik) që zotëron dhe operon, si dhe paraqet koston e përafërt të prodhimit të energjisë elektrike për çdo muaj dhe vjetor;

- Furnizon të gjitha kontratat që ka lidhur apo parashikon të lidhë për shitjen e energjisë elektrike te kompania(të) e shpërndarjes (nëse do të ketë të tilla), te klientët e kualifikuar apo për eksport jashtë vendit.

- Nëse parashikon eksport jashtë vendit duhet të paraqesë përveç kontratave edhe tregues të tjerë të këtij programi, si programin e eksportit (energji dhe fuqi) për çdo muaj, programin e përafërt dhe tip ditor të fuqisë së eksportit etj.

SHTOJCA B

Përkufizime

1. “Shërbimet ndihmëse” janë shërbime operimi të interkonjektuara të identifikuara si të nevojshme për të kryer transferimin e energjisë elektrike mes operatorëve blerës dhe shitës (transmetimi) dhe që një sigurues i shërbimeve të transmetimit duhet ta përfshijë në tarifën e transmetimit me akses të hapur.

2. “Vetë-prodhuesi” është një person që prodhon energji elektrike nga e cila të paktën 70% e përdor për përdorim vetjak.

3. “Tregu balancues” është një treg konkurues ofertash për të siguruar energji balancuese për të siguruar bilancin e sistemit në kohë reale në çdo orë.

4. “Shërbimi balancues” është një shërbim i siguruar nga operatori i sistemit të transmetimit për të kompensuar mungesën e balancës nga shitja e energjisë të gjithë pjesëmarrësit e tregut që janë në mungesë dhe që blejnë energji nga të gjithë pjesëmarrësit e tregut që janë në tepricë.

5. “Blerës” do të thotë çdo pjesëmarrës tregu, që blen energji elektrike nga pjesëmarrësit e tjerë të tregut.

6. “Bashkëprodhim” është prodhimi i kombinuar i energjive të dobishme elektrike dhe termike, i cili siguron një kursim të konsiderueshëm të energjisë, krahasuar me prodhimin e ndarë.

7. “Kufizimi” ose “Reduktimi i ngarkesës” është një procedurë për reduktimin e ngarkesës për të plotësuar kufizimet e burimeve siç aplikohet te: klienti (klientët), grupet e klientëve, zona (zonat) e shpërndarjes ose kompania (kompanitë) e shpërndarjes dhe/ose gjithë sistemi i energjisë.

8. “Lista e kufizimit” është një listë klientësh, grup klientësh, zona shpërndarje ose kompani shpërndarje përfshirë në planin e kufizimit.

9. “Plani i kufizimit” është një plan i hartuar nga kompania e shpërndarjes për të reduktuar ngarkesën gjatë mungesës së kapacitetit dhe që operohet nga qendra dispeçer.

10. “Qendra dispeçer” është një njësi e OST-së që programon dhe dispeceron burimet e sistemit për të plotësuar kërkesat e ngarkesës elektrike dhe për të siguruar operime të qëndrueshme të sistemit.

11. “Dispeçerimi” është rregullimi i prodhimit të energjisë elektrike sipas kërkesave të konsumit në nivel kombëtar.

12. “Shpërndarja” është transporti i energjisë elektrike në sistemet e shpërndarjes së tensionit të mesëm dhe tensionit të ulët me qëllim për ta shpërndarë te klientët fundorë.

13. “Kompania(të) e Shpërndarjes” është një person i licencuar për të kryer shpërndarje dhe furnizim të energjisë elektrike brenda një zone të caktuar. Për sa kohë kjo kompani(të) nuk është krijuar, ketë funksion e kryen divizioni i shpërndarjes së sh.a. KESH-it.

14. “Kodi i funksionimit të shpërndarjes” është një tërësi rregullash teknike, që drejtojnë operimin e rrjetit të shpërndarjes dhe vendosin kushtet dhe termat e shërbimit që kompanitë e shpërndarjes u sigurojnë klientëve.

15. “Energji elektrike” do të thotë energji elektrike dhe kapacitet elektrik, përveç kur konteksti

e kërkon ndryshe.

16. “Enti Rregullator i Sektorit të Energjise Elektrike” ose “ERE” është institucioni rregullator i sektorit të energjisë elektrike që operon sipas ligjit për sektorin e energjisë elektrike.

17. “Klient i kualifikuar” është klienti që për energjinë elektrike që përdor për nevojat e tij, ka të drejtë të zgjedhë dhe të lidhë kontratë për blerje të energjisë elektrike nga çdo furnizues i kualifikuar, vendas ose i huaj, i licencuar.

18. “Klient fundor” është një klient që blen energji elektrike për përdorimin e tij.

19. “Kompania publike e gjenerimit” është një person i licencuar nga ERE-ja për të kryer aktivitetet e gjenerimit të energjisë. Për sa kjo kompani(të) nuk është krijuar, ketë funksion e kryen divizioni i prodhimit së sh.a. KESH-it.

20. “Kodi i funksionimit të rrjetit” është një tërësi rregullash teknike që drejton operimin e sistemit të transmetimit.

21. “Disbalanca” është diferenca mes fluksit të energjisë të përcaktuar nga një kontratë dypalëshe dhe fluksit aktual të matur të energjisë për një orë të caktuar.

Prodhuesi është në balancë kur prodhimi i tij i matur është i barabartë me livrimin e kontraktuar në një orë të caktuar.

Furnizuesi (i jashtëm apo i kualifikuar)/klienti i kualifikuar/KSH është në balancë kur energjia e tij e marrë e matur përputhet me energjinë e tij të marrë të kontraktuar.

Prodhuesi është në mungesë kur prodhimi i tij i matur është më i vogël së livrimi i tij i kontraktuar.

Furnizuesi (i jashtëm apo i kualifikuar)/klienti i kualifikuar/KSH është në mungesë kur energjia e tij e marrë e matur është më e madhe se energjia e tij e kontraktuar.

Prodhuesi është në tepricë kur gjenerimi i tij i matur është më i madh së livrimi i tij i kontraktuar.

Furnizuesi (i jashtëm apo i kualifikuar)/klienti i kualifikuar/KSH është në tepricë kur energjia e tij e marrë e matur është më e vogël së energjia e tij e kontraktuar.

22. “Prodhuesi i pavarur i energjisë” është një prodhues që nuk kryen funksione të transmetimit ose shpërndarjes së energjisë elektrike në sistemin e energjisë elektrike.

23. “Klient tarifor” është klienti i ndryshëm nga ai i kualifikuar, i cili furnizohet nga shoqëria shpërndarëse, e pajisur me licencë për territorin ku ndodhet vendi i konsumit të energjisë elektrike.

24. “Pika e injektimit” do të thotë një pikë e sistemit të energjisë e pajisur me një ose më shumë matës ku energjia elektrike injektohet në rrjet.

25. “Prodhimi i energjisë elektrike” është prodhimi i energjisë elektrike nëpërmjet transformimit të burimeve të ndryshme të energjisë nga një kompani gjenerimi.

26. “Ligji për sektorin e energjisë” do të thotë ligji nr.9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë” siç mund të jetë amenduar herë pas here.

27. “Sistemi elektroenergjetik” është një sistem i ndërlidhur, i përbërë nga centralet e prodhimit të energjisë elektrike, linjat, nënstacionet dhe pajisjet shpërndarëse, për transmetimin dhe shpërndarjen e energjisë elektrike te konsumatorët.

28. “Prodhuesi i privilegjuar” është një prodhues që plotëson kriteret e caktuara nga neni 39 i ligjit për sektorin e energjisë dhe që gëzon një status të privilegjuar siç përcaktohet në Kodin e Sistemit të Transmetimit (Kodi i Funksionimit të Rjetit).

29. “Furnizuesi i kualifikuar” është një person i licencuar për të furnizuar një ose më shumë klientë të kualifikuar.

30. Furnizues i jashtëm, është furnizuesi i vendosur jashtë vendit, dhe që eksporton energji elektrike te Kompania Publike e Gjenerimit (KPGJ), Kompania(të) e Shpërndarjes (KSH), OST dhe nëse lejohet nga ligji te klientët e kualifikuar.

31. Periudha e programuar e dispeçerimit” do të thotë periudha më e shkurtër për të cilën Qendra Dispeçer kryen dhe publikon një program të planifikuar dispeçerimi të bazuar në ngarkesa të planifikuara elektrike dhe oferta aktuale dhe programin që drejtohet nga pjesëmarrësit për burimet.

32. “Shitës” do të thotë çdo pjesëmarrës tregu, që shesin energji elektrike te pjesëmarrësit e tjerë të tregut.

33. “Transmetimi” është transporti i energjisë elektrike në sistemin e tensionit të lartë, funksioni i të cilit përfshin transmetimin ose interkonjeksionin ndërkombëtar.

34. “Sistemi i transmetimit” është një sistem linjash, strukturash mbështetëse, pajisjesh

transformuese dhe kyçëse që përdoren për transmetimin e energjisë elektrike.

35. “Operatori i sistemit të transmetimit” (OST) është një person juridik shtetëror i licencuar për të kryer transmetim të energjisë elektrike, aktivitete dispeçerimi dhe operime të tregut.

36. “UCTE” do të thotë “Bashkimi për koordinimin e transmetimit të energjisë elektrike”, shoqata europiane që koordinon interesat e operatorëve të sistemit europian të transmetimit dhe që garanton sigurinë e ndërshkëmbimeve mes rrjeteve.

37. “Tregu me shumicë” do të thotë blerja dhe shitja e energjisë elektrike për rishitje, së bashku me shërbimet ndihmëse që nevojiten për të ruajtur qëndrueshmërine dhe cilësinë e energjisë në nivelin e transmetimit.